



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2023:065573  
Datë: 29.06.2024  
Numri i dokumentit: 05876436

CAP.nr.1567/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike - përmbartimore të kreditorve H.H. nga fshati ....., Komuna e Istogut, T.H. nga fshati....., Komuna e Istogut, R.B. nga fshati .....Komuna e Fushë Kosovës dhe Sh.K. nga Prishtina, rr. “.....” pn., të cilët i përfaqëson B.L., avokat në Pejë, sipas autorizimit, kundër debitorës Sh.H P. nga Prishtina, Lagjja “.... rr. “...” nr....., lidhur me çështjen përmbartimore, për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të debitorës, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.122/2023, të datës 11.05.2023, me datë 18.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorës Sh (H) P nga Prishtina, Lagjja “....”, rr. “.... nr....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.122/2023, i datës 11.05.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar PPP.nr.122/2023 të datës 11.05.2023, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të Refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorës Sh (H) P, nga Prishtina, i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit me numër P.nr.269/2022, të datës 30.11.2022, sipas propozimit të kreditorëve H.H, T.H, R.B Sh.K.. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të Mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor me numër P.nr.269/2022, i datës 30.11.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat, Z.B. me seli në Pejë.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i debitores brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të zbatimit jo të drejtë të dispozitave të procedurës përmbarimore, me propozim që të aprovohet ankesa e debitores ashtu që aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta anulohet dhe lëndën t'ia kthejë të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje, apo që i njëjti aktvendim të ndryshohet ashtu që të anulohet urdhri përmbarimor dhe procedura përmbarimore të pezullohet.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i kreditorëve ka kërkuar që Gjykata e Apelit ta refuzojë si të pabazuar ankesën e debitores, duke kërkuar edhe shpenzimet e përpilimit të kësaj përgjigje në prapsim konform numrit tarifor 9 lidhur me numrin tarifor 6 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve të OAK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se

Ankesa e debitores është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i autorizuari i kreditorëve, me datë 30.11.2022, pranë organit përmbarues ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.196/19 i datës 12.11.2019, i plotfuqishëm me datën 02.11.2022 dhe i ekzekutueshëm me datën 14.11.2022.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorëve të datës 30.11.2022, ka nxjerr urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.269/2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin, duke vlerësuar se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.196/19 i datës 12.11.2019, i plotfuqishëm me datën 02.11.2022 dhe i ekzekutueshëm me datën 14.11.2022, i plotëson kushtet si vendim përmbarues i dhënë në procedurë gjyqësore.

Kundër Urdhrit mbi Lejimin e Përmbarimit i autorizuari i debitores ka paraqitur prapësim me datën 14.12.2022, me propozim që të aprovohet prapësimi i debitores ashtu që urdhri përmbarimor të anulohet dhe procedura përmbarimore të pezullohet.

Me përgjigje në prapësim të datës 04.01.2023, i autorizuari i kreditorëve ka propozuar që gjykata ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitores, duke kërkuar edhe shpenzimet e përpilimit të kësaj përgjigje në prapësim, konform numrit tarifor 9 lidhur me numrin tarifor 6 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve të OAK-së.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.122/2023, datë 11.05.2023, ka vendosur që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit i paraqitur kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.269/2022 i datës 30.11.2022, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se debitorja Sh (H) P., brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, duke e kundërshtuar urdhrin për përmbarim me arsyetimin se urdhri për përmbarim është në kundërshtim me dispozitat e procedurës përmbarimore, pasi që dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi. Ndërsa, përfaqësuesi i autorizuar i kreditorëve në afatin e parashikuar ligjor ka bërë përgjigje në prapësimin e debitorit, me arsyetimin se kreditori i kundërshton në tërësi shkaqet e treguara në Prapësim, duke theksuar se kundërshtimet e debitorit janë vetëm sa për ta zvarritur procedurën e përmbarimit, sepse me nenin 22 par 1 pika 1.1 të LPP-së, është paraparë se “Vendimet e Gjykatës janë dokumente përmbarimore”, ndërsa me nenin 24, par.1, të këtij ligji parashihet se “Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbarimi dhe kreditorët për ndonjë dhënie apo bërje, është i

përmbarueshëm po që se ka marrë formën e prerë si dhe ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”. Në rastin konkret vendimi i gjykatës si dokument përmbarimor është bërë i formës së prerë dhe ka skaduar afati për përmbushje vullnetare, andaj i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore të dokumentit përmbarues.

Gjykata Themelore në Prishtinë, në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP, pas shqyrtimit të prapësimit dhe thënieve në prapësim, vlerësoi se i njëjti është i pabazë, meqë arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorës, nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga kjo gjykatë. Gjykata ka vlerësuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë- Dega në Istog, Divizioni Civil, me numër C.nr.196/19, i datës 12.11.2019, i cili aktvendim është bërë i plotfuqishëm nga data 02.11.2022, kurse i ekzekutueshëm është bërë me datë 14.11.2022, në bazë të cilit, organi përmbarues ka zbatuar përmbarimin, është dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 dhe 27 i LPP për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim. Andaj, nga arsyet e paraqitura, gjykata vlerësoi se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave të anulohet aktvendimin për caktimin e përmbarimit e të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 22 paragraf 1, pika 1.1, 24 paragraf 1, 27, 69, 71 dhe 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit e pranon në tërësi si të rregullt dhe të ligjshëm përfundimin e gjykatës së shkallës së parë si në aktvendimin e atakuar, pasi i njëjti nuk përfshihet në zbatim të gabuar të dispozitave të LPP, siç pretendohet në ankesën e debitorës. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, dhe i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt faktin se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, C.nr.196/19 i datës 12.11.2019, i plotfuqishëm me datën 02.11.2022 dhe i ekzekutueshëm me datën 14.11.2022, në këtë rast është dokument përmbarues, në kuptim të nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, ku përcaktohet se “ Dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese”, dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i këtij ligji, ku përcaktohet se “dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit ” ndërsa me nenin 24 paragraf 1 të LPP-së, përcaktohet se “ Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshëm po që se ka marrë formën e prerë si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se “Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Në këtë rast debitori me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Në procedurën përmbarimore behet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës

dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr. 1567/23, me datë 18.06.2024

Gjyqtarja  
Hunaida Pasuli